

3 mars 2016, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA
EC publikon analizën “Trashëgimia kulturore: një histori e patreguar”

EC Ma Ndryshe sot ka publikuar analizën “Trashëgimia kulturore: një histori e patreguar” e cila synon t'i shqyrtojë tekstet mësimore të historisë për shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë, të miratuara nga Ministria e Arsimit e Kosovës, për të parë se si prezentohet në to trashëgimia kulturore e Kosovës.

Nga shqyrtimi i teksteve mësimore të historisë në Kosovë del se trashëgimia kulturore në këto tekste prezentohet në mënyrë tejet të kufizuar. Nuk thuhet asgjë mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe lidhjen e saj me formimin e identiteteve, as për ndikimin që diversiteti kulturor mund të ketë në zhvillimin e tolerancës, pengimin e urrejtjes, të racizmit dhe formave të tjera të diskriminimit që mund të shkaktojnë konflikte. Këto tekste nuk e shpjegojnë fare konceptin e “trashëgimisë kulturore”, e madje as që e përmendin ndokund.

Tekstet paraqesin kryesisht objekte/monumente të trashëgimisë kulturore dhe këto pothuajse kryekëput përmes fotografive. Shumica dërrmuese e objekteve/monumenteve të prezentuara në këto tekste kanë karakter etnik e politik, por edhe kur nuk e kanë, prezentohen sërish në kontekst etnik e politik. Në këto tekste nuk prezentohet fare sundimi sërb gjatë mesjetës në Kosovë, e për rrjedhojë mungon edhe prezantimi i trashëgimisë kulturore, kryesisht i objekteve fetare, të kësaj periudhe. Po ashtu, duke pasqyruar se në këto tekste periudha pesëshekullore nën sundimin osman paraqitet si e errët, nuk figuron pothuajse asgjë nga trashëgimia kulturore e saj. Përrashtim bëjnë deri-diku vetëm tekstet ‘Historia 11’ dhe ‘Historia 12’ për gjimnazin e përgjithshëm.

Sa i takon periudhës nën sundimin Jugosllavisë së Titos (1945-1990), jepen pjesërisht vetëm disa të arritura në fushën e arsimit e të kulturës, por nuk figuron asnjëri prej objekteve/monumenteve të ndërtuara gjatë saj. Kosova po synon anëtarësimin në UNESCO, ndërkohë që në tekstet mësimore të historisë brezave të rinj nuk po u mësohet pothuajse asgjë nga trashëgimia kulturore e saj.

Kjo analizë është publikuar në tri gjuhë, shqip, serbisht dhe anglisht dhe autor i saj është Shkëlzen Gashi. Të plotë, analizën mund ta gjeni në linkun <http://goo.gl/4CICW3>.

Me respekt,
Valon Xhabali, koordinator programi
EC Ma Ndryshe

*Projekti “EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse” përkrahët
financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur*

SOROS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo